



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-41476 dt. 21.08.2023

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Milaim Hajdari, me dt. **24.08.2023** (e enjte) duke filluar në ora **10:00**, në sallën e Bordit të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt.20.07.2023.
2. Propozim Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023.
3. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024.
4. Raporti i punës Janar- Qershor 2023 i Kryetarit të Komunës së Drenasit .
5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Hendbollit Drenica”
6. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “FC Liqeni”
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit “Klubi i Boksit Drenasi”
8. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Futbollit Feronikeli –Femra”
9. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Kv Feronikeli Meshkuj”
10. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “SHKA Shotë Galica”
11. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Kv Feronikeli Femrat”
12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “SHKA SHQIPET E DRENICES”
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit “Kosova në dokumentet e qeverise Amerikane 1945-99 gjatë vitit 2023.

14. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "Fc Feronikeli 74".
15. Propozim Vendim për financimin e Projektit OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, "KV Gryka".
16. Raport i takimit të komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim .
17. Propozim Vendim për miratimin e Kërkesës, Nr06-070/01-39017, dt .09.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, Adenocarcinoma ductalis pancreatis, në shumën totale prej 1,600.00 euro.
18. Propozim Vendim për miratimin e Kërkesës, Nr.06-070/01-41320, dt .21.08.2023, për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes-kancer, Adem. Carcinom, dhe sëmundjes Arrest Kardio respirator, në shumën totale prej 1,600.00 euro.

Drenas, 21.08.2023.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-413.50 dt. 21/08/ 2023

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **20.07.2023**, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 22.06.2023.
2. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi.
3. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Gllgovcit për vitin 2022.
4. Raporti Financiar Janar-Qershor 2023.
5. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba.
6. **Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Hendbollit Drenica”**
7. **Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “FC Liqeni”**
8. **Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit “Klubi i Boksit Drenasi”**
9. **Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Futbollit Feronikeli –Femra”**
10. **Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,”Kv Feronikeli Meshkuj”**
11. **Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” SHKA Shotë Galica”**

12. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” Kv Feronikeli Femrat”
13. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” SHKA SHQIPET E DRENICES”
14. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” për projektin e Lulzim Nika, për projektin Botimi i Librit “Kosova në dokumentet e qeverise Amerikane 1945-99 gjatë vitit 2023
15. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,” Fc Feronikeli 74”.
16. Propozim vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negociim .
17. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, Nr. 06-070/01-19409,dt:25.04.2023,për ndihmë financiare për mjekim të sëmundjes me diagnozë: Aneurisma A-basilaris, SAH dhe HIC, në shumën totale prej 3,000.00 euro.
18. Propozim vendim për miratimin e kërkesës , Nr. 01-070/34686 dt. 18.07.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes me diagnozë Eëing Sarcoma reglumbalis, në shumën totale prej 2.790 euro .
19. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, theksoi se kemi edhe një pikë të rendit të ditës: Raporti i kompanisë KMR ”Pastrimi”

Arbër Halilaj, kërkoj që prej pikës 6 deri tek pika 15 t’i diskutojmë si grup jo një nga një.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota (Për), kundër nuk pati, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. **Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.05.2023.**

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 06 vota (Për), kundër nuk pati, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: 2. **Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi.**

Laureta Thaqi- Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme - duke qenë kordinatore e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ju informoj se e kemi për obligim me sjellë para jush një informim të kuvendit për aktivitetet e KKSB-së megjithëse edhe një antar nga Kuvendi Komunal përkatësisht Drini është pjesë e këshillit, gjithashtu ju informoj se duke u bazuar në udhëzimin administrative për KKSB neni 9 pika 1.8 jemi të obliguar të bëjm informimin për aktivitete të KKSB-së, ne gjatë këtij gjashtë mujori kemi mbajtur përkatësisht për periudhën Janar-

Qershor kemi mbajtur tri takime të rregullta siç parashihihen edhe me ligj përkatësishtë me dt.01 shkurt,23 Mars dhe 18 Maj për të gjitha këto takime ne kemi bër ftesën publike para kohe me të gjitha pikat ku jan njoftuar edhe anëtarët të gjitha këto jan publike dhe janë publikuar ne ëeb faqe po vetem e kemi si obligim me sjell para jush me ju inform që ky këshill është aktiv dhe funksionon dhe po i mbajm mbledhjet sipas ligjit, materialin e kan e pak bashk me pika të rendit po për secilen e publikojm gjithmon edhe procesverbalet e këtyre takimeve në ueb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Gllgovcit për vitin 2022.**

Kamer Rama- Auditor i brendshëm- zyra e auditimit financiare të vitit 2022 në përgjithësi mundem me thënë se raporti nuk është me të gjetura shumë të mëdha përjashtimisht një e gjetur që është rreth pagesave së obligimeve që i kemi për kontratat kolektive drejtorin e arsimit edhe shëndetësis. Në vitin e kalun i kemi pas gjithësej 13 rekomandime ndërsa kët vit i kemi 9 ne i kemi dërgu komentet tona në lidhje me rekomandimin e parë po shihet qartë se obligimet të cilat kanë rrjedh prej kontratave kolektive sektoriale që janë në sektorin e arsimit, shëndetësis që është obligim për pagesën për këto kategori e kan pas Ministria e Shëndetësis, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave ne gjatë vitit i kemi ba kërkesë Ministrisë së Financave me e rrit buxhetin edhe për kundër që na kan shut është Kushtrimi këtu me dhan një shifër të sakt edhe për kundër asaj shtese prap obligimet tona kan qenë shumë më të mëdha edhe ato nuk e kanë mbulu mjetet financiare që jan përdor sipas kontratave kolektive, këto pagesa janë realizua përmen vendimeve gjyqsore edhe normal që thesari na i ka marr mjetet prej kategorive tjera, edhe zyra komtare e auditimit e konsideron ktë si një keqklasifikim të mjeteve sikur të themi ka marr mjete prej investimeve kapitale, ka marr mjete prej mallrave dhe shërbimeve ka bër pages faktikisht për pagat. Në komentet tona që ja kemi dorzu zyrës komtare të auditimit e kemi evidentu qart që nenin 45 të kontratave kolektive të arsimit me nr. 105 të datës 22.01.2021 parashihet që Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësis dhe ajo Financave duhet të angazhohen bashkarisht që t'i përmbushin obligimet që rrjedhin nga neni 35 i kësaj kontrate gjë e cila nuk ka ndodh në tërsi këtë e kan një pjes mirëpo obligimet tona kan qenë shumë më të mëdha sesa këto, ne e kemi pas bë një parallogari deri me 31.12.2021 veq prej kontratave kolektive dikun obligimet e komunës na kanë dal 5.milion e 200.000 euro kështu që nuk kemi mujt në tërsi mi mbulu kto edhe janë realizu përmes vendimeve gjyqsore, ato qka realizohen përmes vendimeve gjyqsore shkaktojn edhe keqklasifikim. Sa i përket të gjeturave tjera i kemi ndërmarr disa prej veprimeve në mënyr jo shumë të shpejt p.sh te taksat në biznes me sa e di unë është përgadit një propozim i ri i cili nuk e di a ju ka dërgu ende juve a e keni aprovu ju lus që ta aprovoni në kuvend se ngarkesatv e taksave po ndryshojn veprimtaria me të cilen merret biznesi po ndryshoin me shifren e veprimtaris që e ka të regjistrueme biznesin kështu që po na lypet me pas një përputhje edhe ne e kemi përgadit një propozim vendim të cilin presim me aprovu nga ju në kuvend në mënyr që mos të kemi mospërputhje gjatë faturimit ose gjatë qarjes së tyre vendimeve poashtu gjatë kësaj kohe e kemi përgadit edhe planin e veprimt për zbatimin e këtyre rekomandimeve, mendojm që jan rekomandime të zbatushme dhe Brenda një kohe shumë të shkurt kan me u zbatu unë për fillim kaq kisha.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- ky opinion i kualifikun për Komunën tonë ka ardh si rezultat i kontratave kolektive ku komuna jonë po as komunat tjera të Kosovës nuk janë përgjegjse për kontratat që i kanë lidh ministrit e caktune, komuna nuk i ka zotë ose nuk ju ka dhan një kod prej ku me u pagu si rezultat i kësaj ne e kemi padit ministrinë e shëndetësisë, arsimit edhe ja kemi shtu edhe damet që janë bërë tash së shpejti pasi i kemi marr opinion e këtyre ministrive ja kemi dërgu edhe një shkres plotsuse ku kemi deklarë se si rezultat i kontratave e që nuk kanë të bëjnë me neve Komuna i ka humb mbi 6 milion euro si rezultat i kontratave kolektive dhe rrezikojm me i humb mbi 3 milion euro e shohim kur të renditemi në garën e performancës e shohim sa euro i humbim saktësisht kur të del rezultati dhe domëthanë dikun 9 milion deri 10 milion euro dame na janë nga qeveria e auditori na e ka nxjerr ne për keqklasifikim për diçka që nuk është kan përgjese e jona, padin mund t'ia bashkangjitem materialeve nëse është dikush i interesuar me i pa materialet e kuvendit edhe mundemi me shqyrtu, dmth ne jemi duke i ndjek procedurat të cilat na takojn ne, ne po dyshojm që qellimisht neve dhe komunat tjera na kanë dhënë opinionin e kualifikum veq me na eliminu prej gradit të performancës në rast se nuk ka zgjidhje tjetër.

Arbër Halilaj- raporti i auditimit është një çështje shumë e rëndësishme që ka të bëjë edhe me transparencën e qeverisjes Komunale llogaridhënjën dhe me gjetjet që figurojnë qoft nëse kthehmi të viti 2021 ose viti 2022 që është auditu këtu ka çështje të përsëritura që duhet merren seriozishtë mendoj që duhet të rritur roli, përgjegjësia dhe angazhimi i zyrtarëve financiar auditori i brendshëm që këto çështje të filtohen ose të auditohen para se të shkojnë në ZKA mirëpo çështja kryesore që është ngritur këtu është realizimi i vendimeve gjyqsore përmes gjykatës përmbasuesve që natyrisht që e dëmton shumë buxhetin e një komune të vogël si Drenasi me shifrën që i ceku edhe Kryetari, mendoj që kjo çështje duhet ngritur përveq në aspektin gjyqsor me padi që u cek dhe në takimet me zyren komtare të auditimit në asociacionin e komunës sepse është çështje që nuk mund ta ketë vetëm Drenasi që lidhet me kontratat kolektive e që duhet ngritur edhe në takimet ndoshta kryetari edhe e ka ngrit në takimet asociacionin e komunave dhe me qeverinë sepse po flasim për qeverisjen lokale dhe qendrore a ka kompetenca komunale edhe të delegume prej nivelit qendror kështë që nuk mund të jet një raport i asaj që a e humbim grandin apo në qfar do forme dëmtohet buxheti qytetarëve të Komunës së Drenasit, për gjetjet tjera konkrete diskutojm edhe në seancë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- sa për njoftim Arbër edhe asociacioni i komunave i ka padit dy ministri po ne jemi kan të parët edhe mbi bazën e padisë tonë edhe ata e kanë ba padin edhe pse unë kom kërku me kohë me padit ministrit për me mujt me ndërpre kontratën po komunat tjera në atë koh nuk kanë pas kërkesa për pagesa të kontratave kolektive kemi pas veq ne nuk janë lodh fort kur ju ka ranë në kurriz atyne hajde tash e bojm po unë e kom ndjek proceduralisht edhe e kom dërgu ankesën në gjykat.

Florentina Elezi Velu – jam e interesuar me ndëgj arsyetimin për këtë gjetjen e dytë ku është pagesa për punë të pa kryera qysh është e mundur me u ba pagesa?

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci – kur ta lexojsh raportin e auditorit e kupton mos e lexoni veq pjesën e parë lexo edhe një paragraf ku thotë nuk ka punë të pa krye mbikqyrës kan ba pages për punë tjera që nuk janë kan në radh me i pagu edhe kan mbet këto pa pages edhe

punët që sigurisht janë kry ndërkoh e keni në raport që janë kryer të gjitha punët aty ku thot jan pa pagesa auditori nuk e shkrun njëher tani me e hjek ai kur e ban auditimin shkruan qka ka gjet në atë moment.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e kater të rendit të ditës: **4. Raporti Financiar Janar-Qershor 2023.**

Kushtrim Bajraktari – performanca e të hyrave për këtë periudhë është si vijon: për vitin 2023 deri në këtë periudhë janë 2,686,061.63 euro të hyra e në krahasim me vitin paraprak është tejkalim 245.35% tek të hyrat i kemi për secilin burim të hyrave, tek shpenzimet raporti i shpenzimeve poashtu i paraqet të gjitha kategorit e shpenzimeve dhe krahasimin me periudhen e njejt të viteve paraprake krahasimin me përqindje në raport me vitin paraprak të shpenzimet totale deri me 30 qershor janë 7,875,474.00 € apo në krahasim me periudhen e njejt është 115% shpenzimi më i madh se periudha paraprake, tek paga dhe medijtjet 98% të shpenzimeve në periudhen e njejt arsyeja pse është 98% shpenzimi buxhetit për gjasht mujorin e parë të këtij viti ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit të pagave, ligji i pagave ka hy në fuqi me 04.shkurt ndërkaq buxheti është i aprovun edhe i planifikun në shtatorin e vitit paraprak domethanë ligji ka efekt retroaktiv në buxhetin paraprak edhe për këtë arsye shpenzimi është kaq i madh kryesisht sfida që e kemi te paga të buxheti kryesisht është rritja enorme që është fusha të aspekti politik kryesisht është diferenca më e madhe psh të kuvendi është 100% ka rritje të pagave për këtë arsye shpenzimi është kaq i madh në gjashtë mujorin e parë të këtij viti.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestw të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha.**

Muhamet Gjoka- përveq materialit që e keni për plotsim ndryshim rregullores edhe sektorit te arsimit i kemi edhe si propozim per plotsim ndryshimin e kësaj rregullore nëse e keni rregulloren përpara bëhet fjal për nenin 20.3 ku është një korigjim i shumës që sigurisht ka qen një gabim teknik, ne po mendojm që në shtator me fillu me tarifat të korigjume ka qen në konsultim me auditori do të thot ne kemi propozu që të korigjohen këto dy nene. Neni 20.3 shuma ka qen shuma ka qen 59 euro duhet të jet 55 dhe neni 20.4 ku shuma ka qenë 69 euro ndërsa duhet të jet 65 euro është në pyetje ndryshimi prej 4 euro po duhet të rregullohet sepsenw rregullore ka qenë gabim teknik mundeni me pa edhe rregulloren.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- këti propozim vendimi që e ka ba Agnesa i shtohen edhe këto dy propozim ndryshime në këtë vendim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestw të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për financimin e Projektit të OJQ-ve nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Klubi i Hendbollit Drenica”**

Arbër Halilaj- ne i kryejm të gjitha detyrime në mënyr që ti qbllokohet domethan i ka të bllokune regjistrimet e transferimeve në FIFA përndryshe jam për me financu edhe këtë klub.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Arbër kur u ra klubi i futbollit feronikeli prej superligës të gjithë e dini që u ra për shkak të donatorit kryesor që i cili e ka lënë fronikelin në

mëshiren e kohës dhe nuk i ka pagu lojtarët as stafin teknik lojtarët kanë kërku me i pagu nja një pak ose dy dhe ju ka thënë që të shkojnë në Fifa se nuk mundem me ju pagu, kur ata i kanë kontratat në FIFA që i kanë pas për 24 muaj për 12 muaj dhe Fifa na e ka blloku transferin e klubit i cili fuzionu por që nuk ka pas se kush me i ndjek procedurat, sa për sqarim Fifa e ka një formular ku i bën pikat, psh ka than klubi siniorët i ka pas dy ose tre lojtar po qka kanë ba kur u fuzionu komplet klubin e U21 U19 U17 i ka regjistru as një ndryshim në klubin e ri edhe Fifa ka than në tik që janë 44 lojtar që janë trashëgimi e ish klubi, t ka than stema është e përafërt e njëjt, klla than që po luajn në të njëjtin stadion të Komunës duhet me pas avokat ose dikush me u përgjigj që stadioni është i komunës ja jep me qera kujt të don pa pare duhet me tregu që ata të ri që janë me pa klub ju ka kti klubi domethan janë 6 ose 7 tika që janë kta me pesë pika tjer dhe aj ka than që ky klub është trashëgimtar i atij klubit tjetër si rezultat i kësaj i kemi hy temave dhe donator të ndryshëm duke na i shlyr borgjete për me mujt me liru transferin ne i kemi shly borjete për aq sa keni pas nëse nuk gaboju 10 lojtar ndërkomtar të cilët e kanë dërgu edhe ata i ka fshi janë procedura që duhet të përfundojnë ne edhe ashtu jemi licencu ose qertifiku edhe prej ministris së Kulturës Rinis dhe Sportit dhe ne duhet të vazhdojmë garenë uroj që Feronikli këtë vit të qëndroj në superlig synimet janë me mbetë a mbrim me shku ma lart është diçka tjetër duhet me mbetë në superlig për me mujt me u riorganizu me pas prap trofe qysh i kemi pas, unë kom dëshir si Kryetar Komune me e rujt të kalmen sepse prej Mehdi Hajdarit që është në SHBA deri në lojtarin që sot luan për Feroniklin kanë krenari me rujt trashëgimin edhe të gjithë ata lojtar që kanë lujt në kohën e paralufitës e që më nuk janë në jetë familjet e tyre e dojnë trashëgimin dhe ne kemi mujt me u fuzionu me Drenasin. Drenasi na ka ofru me u fuzionu 100% pa asnjë cent dëmshpërblim po për hir të kalumës unë ju kom ndihmu që me gjet donator edhe me i shly aty ku mundemi me i shly borjete ku nuk na falin ose nuk na i zbresin edhe me vazhdu më tutje a janë shumë a janë pak mundem me ju than që është shumë minimale për superlig, shtrohet pyetja klubi ligëni i ka nda 15.000 a i ka 9 lojtar llogarit këta i kanë 70 lojtar sepse të gjithë kategorive duhet me shpenzu pa e llogarit këtë që 30 janë veq te siniorët ose te ekipa e parë pastaj është U21 që e kemi obligim edhe duhet me dit që paga minimale është 300 euro që duhet me ja dhënë më së paku edhe një lojtar që i ka 16 ose 17 vite që është i regjistru në U21 që duhet me ba kontrat me ta është qajo pag kështu që unë i falenderoj donatorët shpenzime të mëdha janë bër me u rikthy Brenda një viti që gara është më e madhe edhe është vështir me kthy ne po të mos ktheheshim Brenda këti viti ma kishim harru kur kemi me u kthy sepse gara është më e madhe edhe ma vështir me u rikopuru, kemi arrit ndërsa për ekipet tjera ndoshta nuk janë të mjaftueshme po ne kemi me u kthy po sa kemi pas buxhet jemi mundu me ba komisioni ka me u mundu me i shprehenda sa më të arsyshme dhe ma të barabart.

Florentina Elezi Veliu – unë pajtohem me kolegun Arbërin, Kryetari e sqaroj po nuk e di a mundem me u bazu në fjalët e kryetarit për këtë shumë qoft për feroniklin qoft për naj klub tjetër, pajtohem që duhet me ba një projekt të pakten një arsyetim dy rreshta ama kjo letër kaq e zbrazët me i jep 70.000 euro po më duket shumë se kjo shumë janë shumë për buxhetin e Komunës së Drenasit, një klubi me i a jep 70.000 euro edhe diferenca është shumë e madhe me klubin tjetër është pa një arsyetim të pakten zyrtar ose një projekt unë për vete nuk mundem me votu ndoshta nuk keqkuptohemi sikur për Sheshin që thojshin njëri prej asambleistav kundër dëshmorve tash me thënë edhe për kta jemi kundër me ardh dikush në shtëpin time më kërku 70.000 euro më intereson qka po i vijnë e le ma Komunën duhet me konsideru sikur shtëpi tonën

kështu që të paktën pa një arsyetim zyrtar prej klupi ose me fjalë e shkrun me e sjell në seancë që të paktën me ditë që kemi me votë për secilin klub.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Florentina klubi feronikeli nuk është personal i jemi komisioni i ka të gjitha shkresat mundëni me i pa, qëdo propozim është transparente, na e shpjegum një klub që i merr 15.000 euro me 8 zyrtar dhe një që i ka 60 janë aq pak edhe është tjetër kategori domethan shpenzimet e kërjt na i kemi arsye të qështje e juaja e votës së juaj a i ndani apo nuk i ndani por kur thonë jo 60 po janë mbi 120 lojtar, e trajnera e staf.

Azemine Bujupi – nëse ne nuk pajtohemi me një shumë që është kaq e madhe 70.000 euro kemi të drejtë me kërku sqarime se qytetarët ndoshta kanë ndonjë kërkesë tjetër nuk ka nevojë me fol fjalë ofenduese.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Azemine sa për sqarim shuma a është e madhe apo e vogël është vendim i juaj qysh e votoni po mëm than që ka kërkesa tjera të qytetarëve kjo është kategori subvencione e caktuar me votë të kuvendit me shumë të caktuar për Kultur, Rini dhe për Sport pra mëna kategoris për sport është shuma e caktuar e shpërndarë sipas komisionit vlersues nuk ka të bëjë me kërkesa të qytetarëve sepse këto janë mjete janë nga ministria e Financave të ndarë podi se shuma caktohet nga niveli qendror ne e përcaktojmë ku me i shpërndarë

Hamit Haxhiu – po lidhem me Kryetarin tha që për Liqenin që janë 15.000 e për FC74, 70.000 këtu në mënyrë proporcionale qysh the 60 lojtar i ka Fc “Feronikeli” edhe 9 lojtar i ka Liqeni nëse e pjeston është në mënyrë proporcionale që është dikur 1266 për një lojtar, nuk është ato që po e thu ti për Liqenin që i ka 9 lojtar i ka 15.000 euro e për Feronikelin që i ka 60 lojtar që e potencojë janë 70.000 nuk jem kundër klubin e kësaj përkrah edhe na ka bërë krenar në qafard fusha të sportit. E kemi diskutuar në mbledhjen e fundit që qëdo projekt të vijë në kuvend edhe të diskutohet projektin për që duhet me u zhvilluar edhe mjetet të cilat janë të dedikuara për të gjitha pikat e sidomos për feronikelin.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Hamit nuk e kuptova që deshte më than nuk janë 60 lojtar po janë 120 lojtar sigurisht që U19 U17 e tjer nuk paguajn përveq se transportit edhe trajnerat se nuk i të gjitha, lojtarët e futbollit të madh dhe lojtarët e futsallit kanë dallim si në pagesa e trajnime në kohë të zhvillimit të garave sin në minutazh kanë dallime ata e kanë lojën 40 minuta kësaj e kanë 90 minuta ata i kanë 2 ose 3 muaj gara, këta i kanë 11 muaj gara nëse ke bërë krahasim komisioni ka shpërndarë se me pas muajt ja kisha qit ka 200.000 euron po nuk është temë e jemja komisioni e ka bërë është e juaja me votë, nuk e di as proporcionin qysh e ka nda sigurisht e kanë nda për këto tema nuk është si një lojtar që paguhet 3000 ose 4000 euro si një ekip që e kanë me 4000 euro kërjt sezonin pra na edhe me hendboll kemi pas problem u dasht me thirr, njëri hanc nuk e ka kompletu dosjen më i bërë presion më prë dosjen u dasht më i eliminuar përshkak se nuk e ka sjell dosje e raportin që kishin më i zvogluar shumat e qëdo ekipi në sport për më marr edhe ata diqka. Unë mëdoj që është shumë e vogël kësaj në krahasim me shpenzimin edhe më kënaqësin që na je psi qytetarve i Drenasit faleminderit

Hamit Haxhiu – Kryetar unë nuk thash që janë shumë e pak ajo që mundëmi më bërë për klubin po lidhna më ata që ti e potencojë kubi i liqenit e ka një vlerë të madhe në qoftë se e merr mënyren proporcionale projektet e këto janë të hartuar prej ekspertëve të futbollit nuk janë të

hartune prej neve mënyra proporcionale është ajo që e thash më herët në rregull jamë vetëm që projektet të jen të shohim qfar projekti ka klubi qka mendon me ba me 70.000 euro

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- për dëni të krejt antarëve të komisionit për Politikë e Financa 70.000 euro as një pagë të plotë nuk e kryen në klubin FC Feronikeli, paga juore e siniorëve edhe U21 nuk i kalon mundesh me e kry një pagë pa i shti shpenzimet tjera ushqimin, ndresat e të gjitha ato qka shkojnë domethan një pagë kërkohet me hjek Komuna me i dhënë subvencion Feronikelit falemindertit

Arbër Halilaj-esenca e krejt diskutimit ishte dikun tjetër jo se nuk po mundem me hi në detaje se nuk mund me krahasu as si klube e di që asnjërit prej klubeve nuk ja plotëson shpenzimet për aktivitetet që i kanë për licencime e për gjëra tjera I din drejtort sportive, krejt esenca është për me u mësë kërkuar apo klube e shoqata kushdoqoft me u msu me ba projekte arsyetime raportime financiare me ardh me këto raporte edhe pse po ceket shumë Feronikeli se ka pas aq shumë turbulence që e përmendi prej kryetarit të më hërshëm që e ka lënë në balt me obligime e ndryshimi i emrit e ndryshime tjera hymja në superlig sa që për krejt periudhë është dësht me një seancë të veçantë me raportu dikush prej klubit kur kërkon subvencionim duhet me mundësu edhe raportime këtu është esenca përndryshe secilin prej këtyre me subvencionu, secili i ka meritat, rezultatet, aktivitetet që na bëjnë krenar edhe nuk jamë për me përjashtu asnjërin prej këtyre të shumtë është që kërkuar prej parashtrusëve të kërkesave nuk është e mundur me ia mbulu krejt shpenzimet për aktivitetet që i bëjnë faleminderit

Hamit Haxhiu- pyetje për Drejtoreshen e Kulturës rinis dhe Sportit sa lojtar i ka shkollë e Feronikelit për të gjitha grupmoshat edhe sa bëjnë pages lojtarët e grupmoshave të ndryshme

Enkela Dema- Drejtoreshë për Kulturë Rini dhe Sport- siq e tha edhe kryetari 120 janë total i lojtarëve në shkollën Feronikeli. Feronikeli është shkollë po kategorit që paguhet brendapërbrenda klubit janë siniorat e juniorat 21 që dikun janë 60 ose 70 lojtar që duhet me u pagu

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Është pyetje që nuk mundem me të dhënë përgjigje tash duhet më vonë se ne nuk e administrojm shkollën e Feronikelit edhe nuk e dim a ka shkollë feronikeli a nuk ka se tjetër statut tjetër emër këtu krejt ia kanë gjujt feronikelit Vetëm ushqim nuk ju dalin këto pare krejt me i qit veq në ushqim kështu që du me thënë që na nuk kemi raport dhe nuk është tem e jona raporti fëmijëve sa paguajn edhe kush i merr, i marrin vetëm trajnerat me sa kam informacione që nuk kam të bëj fare me feronikelin trajner punon me U11 13 15 edhe merr pagë ajë duhet me ardh me punu 8 orë prej klubit jo me i marr për 80 minuta edhe aj i mbledh ato pare prej prindërve të fëmijëve. Një vit më kanë akuzu te prindërit se gjoja kryetari ka kërku me e shtrejtë po unë as nuk jom perzi as nuk përzihem po jam për me i hjek krejt me i marr talentat që i ka komuna që don mrena komunës me i than nuk keni nevoj me pagu po ata kanë me lujt për klubin edhe kanë me pas se nëse bëhen talanta klubit i vin të hyra me i marr diqka mjafton me i marr 20.000 ose 30.000

Hamit Haxhiu- unë vet e kom pas djalit edhe kur e kom dërgu unë e kom ba vet pagesen e madhe është më feronikelit edhe FC - 74 tash ne e financojm prej komune donator knej e ka shkollën e futbollit që ka lojtar U11 e U 7 e qysh janë të ndane ato të specifikune sat ë duash

fusha sintetike po kur shkojm të mjetet një lojtar paguan 20 euro në muaj për ushtrime, problem është se ku shkojm ato mjete këtu po e kuptoj që është një avulli në mes klubeve FC74 edhe feronikelit nëse unë e kom regjistru djalit ku është në klub të feronikelit jem në rregull, e kom paku vleren shembull ka shkojm ato pare Komuna financon një donacion psh Fifa financon prej shkollës futbollit që e paguajn lojtarët e fëmija qatu deshta me dit numrin e përgjithshëm sa është I lojtarëve

Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari- nuk ka të bëj me ato grupmoshat asgjë mënyren e funksionimit të grupmoshave të gjithë e kemi atë shqetësim t'i i paguan 20 euro aty a hyn garderoba a nuk hyn është diqka tjetër ajo nuk ka të bëj edhe Kryetari e tha mir është klubi si OJQ mi përfshi ata me I pagu ata klubi participojn prindrit a jo sotpërsot nuk ka mundësi, as një klub i supërliges së Kosovës sot nuk ka shank një sezon pa 2 milion euro me përmbyll, nëse neve na doken 70.000 euro shumë jan sjumë se kem pak subvencione ama shpenzimet janë jashtzakonisht të mdhaja.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- Ju that që 26 lojtar mundet me i pas një grupmosh here 20 euro po bejn 520 euro domethan qito paga i marrin një trajner a dy trajnera kët po du me than me ja hjek klubit kur ti ka mundësit edhe mi ofru talentat është ma mirë edhe prindi po lirohet prej atyre 20 euro.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim prej piks 6 deri tek pika 15, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me: 06 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati. Shkojmë tw gjitha si rekomandim p

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës: **16. Propozim vendim për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë Kryetarit të Komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuarra për dhënie të pronave me negociim .**

Nënkryetari i Komunës Arben Shala- përshëndetje për të gjithë me ligjin 06 092 neni 11 par 3 për dhënen në shfrytëzim të pronave të palujtshme të Komunës, dhënja e pronave me negociim është e drejt e Kryetarit por me në i kemi pranë dy kërkesa mundemi me lan më von për pronat në shfrytëzim afat gjatë Kryetari ka vendos për hir të transparencës m e kriju një komision edhe pse nuk parashihet me ligj nuk është e domosdoshme se është e drejt e Kryetarit ekskluzive që me I realize kërkesat edhe me dhën rekomandime e sygjerrime me këto kërkesa në qoftë se është nëvoja a ,e laboru për këto kërkesat, parashihet me u punësu 24 persona sigurisht që Komuna përfiton nje megavat për një vit është fjala 1000 euro parshihet që minimum me qen 42 kërkesa tjetër është për një ferm është një kompani gjermane platform ... në shfrytëzim që ofron njejt sikur ne gjermani eshte 319 për hektar sigurisht do të sponzorizoj aktivitetet sportive kulturore me 10000 euro në vit është fillestare investimi parashihet të jet 8.9 milion euro edhe do të rritet pastaj 20 a 40

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- Një sqarim domethan Hmit kjo qak e tha Arbeni tem në veti është kërkes unë e kom propozu me pas një ekip e cila I negocon këto tema ju shkoni folni kush thot prej qdo grupi parlamentar shkoni negoconi qysh të merreni vesh jut ash temat I

dini rekomandonmi mu që unë me ja propozu kuvendit prap kuvendi vendos qka me ba ;po transparenca me ju tregu domethan na jem të detyrum kërkesat që I bëjm e që I protokolojm në komun me ju kthy përgjigje, spo du me I kthy po du ju me pa gjithqka për transparenc edhe me shty ose me mbyll atë tem me ligj Brenda afateve kjo është tema e panellave jua kan spjegu tema e pulari ose e rritjes së pulave është superfuqia në evrop e prodhimit të pulave që po don me ardh ten a dhe prodhimi ka me pas emrin Made in Kosova ... akoma ma e madhe unë me u vet sot ja jepi domethan aj përveë punësimeve edhe zhvillim ekonomik të komunës po është tem që ta trajtoni ju nëse kuvendi pajtohet me ba komision edhe me negocu me ta edhe mem ba rekomandime unë e kom me ligj munmdem me I ba vet negociatat po muk kom nevoj me I ba e qes komisionin nëse pranon me votu edhe ecim përpara nëse dëshirojm me I a dhën po nëse jo unë nuk kam as një problem në kët drejtim faleminderit.

Arbër Halilaj- siq tha edhe nënkryetari është e sakt se ligji I përcakton që pronat publike qoft në shfrytëzim shpronsimet këto janë kompetenca që mund me I negociu vet, unë jam pro këti propozimi që të krijohet një komision ndoshta 5 antarësh prej kuvendit me koleg e kolege që ndoshta nuk janë të angazun në komisione tjera pastaj projektet konkrete dhe rekomandimet na vin prej komisionit në asamble dhe nuk kem pse me I diskutu këto sot faleminderi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestw të rendit të ditës: **17. Propozim vendim për miratimin e Kërkesës, Nr. 06-070/01-19409,dt:25.04.2023,për ndihmë financiare për mjekim të sëmundjes me diagnozë: Aneurisma A-basilaris, SAH dhe HIC, në shumën totale prej 3,000.00 euro.**

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- Ta keni të qart kërkesat janë duke ardh të mëdha, ne kur ta hargjojm bugjetin nuk kem me pas mundësi me ndihmi që ta din edhe qytetarët ne për fëmijë edhe sëmundjë të rënda sigurisht I kemi ba propozimet edhe I kemi qu në kuvend po kom frik që është duke na u ba pak shprehi, unë e di që kan krejt nevoj po kam frik që shumë shpejt buxhetin për kët qëllim kem me e shpenzu duhet ngrit edhe në kuvend si tem, ne nuk guxojm me mbet krejt pa buxhet se mund me pas raste që duhet me ndërhy ta shohim

Hamit Haxhiu-a mundemi me ba një kod të veqant për këto me planifiku një gjasht mujorëshin e dyt ose për vitin e ardhshëm që jan qdo her vin kërkesa sit ë njehta kem edhe ne nëpër shkolla, me ba një kod të veqant ose një vler të caktume që me I ndihmu aq sa I ki qato mjete në mënyr proporcionale ose varsisht prej kërkesave të cilat I bojm të njejten e kem edhe nëpër shkollla

Kryetari I Komunës Ramiz Lladrovci- Hamit ne e kemi shumën e caktune na qat podin qat kufinin edhe në kët aspect ministris ne nuk guxojm me dal jasht kësaj është sitate e rënd ku kemi subvencione dikun deri 1500 euro unë muj me ja dhën pa pru në kuvend për kët edhe atëher e kemi ba rregulloren unë zero e kom lan te kryetari po ministria na e ka kthy negativ vendimi n sepse duhet me pas një kuot që kryetari në raste emergjente mos me prit kuvendin me miratu edhe e kan la , na mundemi me ba kët sitate po me shum nuk mujm sepse pod nuk kem drejt ma shumë se qaq na e ka leju ministria

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **18. Propozim vendim për miratimin e kërkesës , Nr. 01-070/34686 dt. 18.07.2023 për ndihmë financiare për mjekim urgjent të sëmundjes me diagnozë Eëing Sarcoma reglumbalis, në shumën totale prej 2.790 euro .**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- e kemi ftu edhe kompanin e ujësjellsit kompanin e pastrimit me ardh me pastru ne e dim që me ligj e kan obligim kur I thirrjm kuvedi me raportu mund të ja dërgojm gjith komunikimin që e kemi pas e kom autorizu arbenin me fol me ta ata kan inform që raport 3 mujor I bojm zyrës së kryetarit edhe nuk kem nevoj me ardh në kuvend me raportu, unë muj me ju deklarë që në imell e kana ta që gjana një raport që ja kemi dërgu kryetarit atëher po pajtohmi që për qdo 3 muaj a e kemi qu me imell at raport, a e kemi qu me protokoll at raport as në protokoll na nuk e kemi gjet e as në imellat ton nuk ka një raport të till kjo është ikje pa edhe na ... komuna ka kriju asete e për të cilat nuk I ka marr ato ato që I ka marr nuk I ka mirmbajt edhe jan dal jasht përdorimit ndërsa pastrami ka than që është I gatshëm me ardh me ba raport njejt kemi kriju asete edhe për ta dy ose tre kamiona veq vitet e fundit me performanc të mirë i kemi fitu edhe i kemi ndihmu po këta të ujësjellsit gjat kësaj jave nëse nuk gaboje e finalizojm edhe një her bazenin e Kamenices me jau rikujtu bazeni I kamenices u kan project i Kru prishtina me deg në Drenas u kan donacion I CDEF-it 73000 euro u kan e kan ndërtu e kemi mbush ujë as një pik të ujit se ka majt se nuk u kan I rregullum. siq ju kom than edhe një her po ju tham rrjeti primar nga bazeni drejt fshatrave qëprap që u kan project prap po ju them un kan project I CDF me Kru Prishtina kam frik që në segmente të ndryshme nuk ka gyp fare të vendosur siq nuk ka pas prej bazenit te feronikelit drejt bazenit të kamenices veq se nuk ka pas gyp e ata që jan kan gypat jan kan të dimensioneve të ndryshme që u dasht me investu ne=ëse nuk gaboje nja 2000 euro tuj përfshi edhe pompat shifrat nëse nuk gaboje veq pompat kan kushtu 160.000 euro për me mujt me shty ujin prej Qikatove drejt bazenit të kamenices, pse me shty ujin sepse pompat e marrin sasin e juit shpejt ndërsa mbesin pa ujë sepse është gypi më I vogël në krahasim me gypin tjetër ma të madhë edhe na u dasht me ba një rezervar tjetër që me mujt me punu pompa me at mekanizmin lëvizës për mos me u djeg pompa po ashtu e kemi stacionin te gjamia në Drenas të cilin e kemi ndërtu I cili dy vite as rrymen nuk e ka pagu e kemi qu na e kemi ba funksional nuk e lëshon ujin në Korrotic, nuk e lëshon ujin për poklek të ri se thot nuk kam puntor që duhet me shku me I lshu e mi ndal nderprersit, poashtu ju kom than shumë her që edhe kur të vendoset me lshu ujin në krejt fshatrat jupër Drenas edhe po ndalet sepse nuk [prodhojm ujë, kur ne kemi kërku e kemi shpall në interes të përgjithshëm liqenin e verbovcit e kemi arsyetu se do të ket ujë të mjaftushëm për 40.000 banor plus rjedha prej liqenit të ujmanit përmen velakut është I mjaftushëm për qytetarër tan ata na e kan hequr edhe prej kodit edhe prej projektit vetvendosja nuk po na I shqyrton as kërkesat e shpronsimit të pronave se na me mujt me ba shpronsimin e pronave mujna me ba edhe me kredi, kemi kompani e gatshme me ardh me ndërtu liqenin po pa e shpronsu na , ministria e ka obligim me ba raportin e shpronsimit në një department atje pa e ba ne nuk mundemi me hy me e zhvillu, nëse kjo nuk bëht dëmtohen qytetari është mir me u ban a I kemi ndjek qdo procedur kemi adresu qdo kërkes edhe ish ken mirë me na kthy përgjigje Florentina kam një lutje që me fol me njerzit e partis tane me siguru edhe ata fitojn në këtë aspekt se nuk I marrim meritat na I marrin ajë që e zhvillon projektin ma shumë na I ndihmojm procedurat ... me na kthy përgjigje, shpresoj që edhe rruga ka me fillu shpejt se qdo projekt I joni lidhet me projektin e qeveris dhe nuk po mundem me zhvillu duke

mendur që po e bajn ata edhe ne po zvarritur në projekte të cilat mundem me t'zhvilloj unë jam detyruar me lëshu rrugën 4 korsi deri në rrugë kryesore të parkingut ku e kemi bashkë sepse nuk po e di a po bajn a po jo edhe ne nuk mundemi me t'mbajtur pezull sigurisht që kemi me bashkë veç hyrja ose lirim i rrethit po nuk kemi me lënë për mu përdor 4 korsi po ne po e krym si projekt, unë i kom kërku personalisht kryeministrit Kurti me na ndihmu në projekte, i kom kërku shpeshher edhe liderëve të vendosjes me na përkrah në projekte të cilat janë në interes të komunës e që nuk na kanë përkrah nuk e di kryeministri edhe kryetari i parlamentit kanë thanë që kemi me ju përkrah po kur vin me shkresa me imellat kërkojnë pikat qita voto për qita kundër është tërë e dikuj tjetër po është pengesë e zhvillimit të komunës

Florentina Elezi Veliu - Në qoftë se është fajti te qeveria na bashkërisht jemi bashkë jemi fuqi edhe mundemi me ju bashkë presion edhe mundemi me ndreq qfarëdo problemi të mundshëm edhe në qoftë se është problemi te qeveria që i përket asaj partie, kur është në pyetje interesi i qytetarëve mu nuk më intereson cila parti është, sa i përket qerdheve e din Drejtori i Arsimit edhe tjetër që kom komunikim i kom thirr bashkërisht me zgjedh problemin e qerdheve është për keqardhje që në Drenas ka qerdhe që janë të pa licencuara numrin e fëmijëve e fshehin nuk e kanë të raportuar nuk është vetëm ten kjo është edhe në qytete tjera hajde ne ta zgjedhim për Drenas kjo është për qytetarët themeli i arsimit është janë kopshtet kur traumatizohet fëmija në qerdhe ma qojë ku të duash nuk ka përmisim e fatkeqsisht në Drenas qerdhet janë për keqardhje edhe kom than hajde ti bëjmë presion edhe qeveris atje ju kom bashkë presion edhe me imellat i kom shkru edhe ministris që edhe atje ka ngecje qysh ka pas edhe më heret, kështu ka me vazhdu edhe tutje përshkak se jemi popull neglizhent i marrim punët vetëm për sot edhe për nesër unë se kom problem e tham edhe në këshill të përgjithshëm të vendosjes unë ja tham të gjithëve kur e keni gabim se kam atë problem, problem i vetëm është pse nuk punohet edhe pse jemi kaq dembelat edhe pse e marrim pozitën kur nuk jemi të zot me zot duhet me pranuar me thanë nuk jam për këtë pozitë edhe me hëk dor, nëse dojmë me zgjidh diçka vetëm bashkë mundemi

Arbër Halilaj - më heret kanë thanë që nuk ka projekte se kishim financuar, tash ka projekte po nuk financohen po flasim për projekte që direkt e prek përditshmërinë e qytetarit e keqja është se sipas informative që i kam se njoh edhe ish drejtorin projekti është i realizuar qaq me defekte aq sa le që nuk ka unë po edhe kur lëshohet ka me pelcit dikun edhe kam me thanë nuk paska gypa ose diçka po nuk di qak thot një menagjer i projektit në këto raste se qdo projekt e ka një menagjer edhe qysh arsyetohet.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci - Po i jap përgjigje Florentinës unë i kom bashkë shkresa, me sms me imellat kërkojnë qeverisë qdo njanit deri edhe pjesës partiake udhëheqëse që i kanë me dega se kom fsheh as se fshehi unë jam transparent në punën time se e kam obligim se qeveria deri në momentin që votohet është e atyre që votojnë në momentin që votohet është e kërkojnë qytetarëve duhet me punuar për kërkojnë qytetarët edhe unë jom mundu me t'zgjell projekte të reja Komunës ose me t'zhvilloj qato.

Sa i përket pyetjes së Arbërit projekti prej bazenit të feronikelit e deri të bazeni kamenices është project të cilin e ka ba një kompani e kontraktume me Komunën dhe mbikqyrsi ka qenë po ashtu një kompani e kontraktume me Komunën ndërsa ata që e kanë pranë punën kur u kry duhet me pranë dikush e ka pranë një ekip e Komunës.

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen,
mbledhja përfundoj rreth orës 11:45 min .

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi 

Indira Olluri 




Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Milaim Hajdari 



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit**



Nr.01 - 432/02-41249 dt. 21/08 /2023

Në bazë të nenit 58 par. 1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, të nenit 12, pika 12.1 dhe pika 12.2, nenit 14 pika 14.1 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 5 Kapitulli II/A I Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2023 të miraton këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023

I.

TË MIRATOHET propozimi - vendimi për për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, i cili rrjedhë nga Neni 5 Kapitulli II/A, Neni 11/B paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

II.

Qëllimi i këtij propozim - vendimi ka të bëjë me faljen e borgjit të tatimit në pronë për vitin 2023, i cili vendim prekë të gjithë tatimpaguesit që kanë detyrime të tatimit mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 ashtu së dhe është përcaktuar në Nenin 5 Kapitulli II/A, të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë në bashkpunim me Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasnfereve - Departamentin e Tatimit në Pronë.

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Ligji Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

V.

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit, Ministria e Financave, Punës dhe Trasnfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Komunës së Drenasit, dhe pas marrjes së ligjshmërisë nga MAPL.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Në bazë të Neni 11/B paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili thotë: Vendimi për faljen e tatimit në prone merret nga kuvendi komunal I çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni I cili thotë: shuma e faljes së tatimit në prone për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në prone për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitetat e këtij kapitulli.

Për më shumë detaje bashkangjitur me këtë propozim vendim është edhe Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

LIGJI NR. 08/L-224**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë progresivitet të shkallës tatimore, lirim tatimor për vendbanimin parësor dhe tokat bujqësore, faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe rregullat kufizuese për aplikimin e detyrimit tatimor, dhe interesit, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Bazik).

Neni 2

Riformulohet neni 9 i Ligjit Bazik dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

**Neni 9
Shkalla tatimore progresive**

1. Tatimi në pronën e paluajtshme bazohet në vlerën e vlerësuar të paluajtshmërisë së tatimpaguesit si bazë tatimore në komunën përkatëse.

2. Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit.

3. Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve në vijim:

3.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.10% deri 1%;

3.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 të këtij neni;

3.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.30% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;

3.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri 1%, plus tatimi nga nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni; dhe

3.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe

3.4 të këtij neni.

4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv.

5. Nëse Kuvendi i Komunës nuk e përcakton me kohë shkallën e tatimit sipas paragrafit 4 të këtij neni, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën e fundit tatimore të përcaktuar nga Kuvendi i Komunës.

6. Në rast se shkalla tatimore nuk është vendosur më parë, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën më të ulët tatimore të aplikueshme në përputhje me kufijtë e tatimit progresiv të pronës së paluajtshme përcaktuara në këtë nen.”

Neni 3

1. Pas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të nenit 10 të Ligjit Bazik, shtohen dy nën-paragrafë me tekstin si në vijim:

1.8. Për vendbanimin parësor, deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit; dhe

1.9. Për tokën bujqësore, deri në pesëdhjetë mijë (50,000) euro e para të pronës së vlerësuar si njësi bujqësore të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor për cilën njësi bujqësore e kërkon lirimin dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.

2. Fshihen paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Ligjit Bazik, dhe vendoset një paragraf i ri me tekstin si në vijim:

4. Lirimet tatimore të përcaktuara me nën-paragrafët 1.8 dhe 1.9, të paragrafit 1 të nenit 10 zbatohen vetëm një herë brenda vitit tatimor për çdo tatimpagues, pavarësisht nga numri i pronësive dhe/ose posedimeve të tatimpaguesit dhe pavarësisht faktit që njësitë mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Neni 4

Fshihet neni 11 i Ligjit Bazik.

Neni 5

Pas Kapitulli II të Ligjit bazik, shtohet Kapitulli II/A me tekstin si në vijim:

KAPITULLI II/A

FALJA E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023

Neni 11/A Pranueshmëria

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli.

Neni 11/B**Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme**

1. Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.
2. Vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

Neni 11/C**Kufizimi**

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

Neni 11/Ç**Administrimi**

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.
2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

Neni 6

Pas paragrafi 1 të nenit 23 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 1.a. me tekstin si në vijim:

- 1.a. Për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Neni 7

Pas paragrafit 2 të nenit 25 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

3. Në asnjë rrethanë llogaritja e interesit në tatimin e papaguar nuk do të vazhdojë të llogaritet pasi interesi i akumuluar të ketë arritur shumën e vetë tatimit të papaguar.

Neni 8

Pas nenit 30 të Ligjit bazik, shtohet neni 30/A me tekstin si në vijim:

Neni 30/A**Afati i parashkrimit të detyrimit tatimor**

1. Afati i parashkrimit të përmbartimit të detyrimit tatimor është dhjetë (10) vjeçar, duke filluar nga data e marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara sipas nenit 30 të Ligjit Bazik.
2. Pas skadimit të periudhës dhjetë (10) vjeçare, detyrimi tatimor konsiderohet i parashkruar dhe komuna nuk ka të drejtë të marrë asnjë masë përmbartimore ndaj tatimpaguesit.

3. Parashkrimi nuk zbatohet në rastet kur:

3.1. Tatimpaguesi ka paguar vullnetarisht një pjesë të detyrimit tatimor pas skadimit të periudhës dhjetëvjeçare;

3.2. Tatimpaguesi ka rënë dakord me komunën për një plan pagese ose shlyerje të detyrimit tatimor; dhe

3.3. Për detyrimin tatimor është marrë një vendim gjyqësor.

4. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë procedurës ankimore ose gjatë një procesi gjyqësor në lidhje me detyrimin tatimor.

5. Afati i parashkrimit rifillon nga data e vendimit përfundimtar të marrë në ankim ose procedurë gjyqësore.

Neni 9

Në kapitullin X të Ligjit Bazik, Dispozita kalimtare dhe përfundimtare, pas nenit 39, shtohet një nen i ri, 39 /A, me tekstin si vijon:

Neni 39 /A

Shkalla tatimore tranzitore

Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejnë dispozitat e ligjit bazik.

Neni 10

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Neni 2 i këtij ligji fillon të zbatohet për vitin tatimor 2025, dhe obligohet Kuvendi i Komunës që deri më 30 nëntor të vitit 2024 t'i caktojë shkallët tatimore konform nenit 2 të këtij ligji.

Ligji Nr. 08/L-224
27 korrik 2023

Shpallur me dekretin Nr. DL-148/2023, datë 14.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

Nr. 1240

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	21. 08		2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	432/02	41248	



**Republike e Kosovës
Komuna e Gllogocit
Zyra e Kryetarit**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Neni 9 i Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon këtë:

PROPOZIMVENDIM

- **Për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2024**

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 4, Kuvendi Komunal i Komunës së Gllogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100.000) euro aplikohet shkalla tatimore -0.10%
- Për vlerën e pronave mbi njëqindmijë (100.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.20%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 i këtij neni;
- Për vlerën e pronave mbi pesëqindmijë (500.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.30% plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;
- Për vlerën e pronave mbi një milion (1.000.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.40% plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni;
- Për vlerën e pronave mbi pesë milion (5.000.000) euro aplikohet shkalla tatimore - 0.50% plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të këtij neni;

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit

Neni 4

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 janari 2024.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Në zbatim të Ligjit Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 4, Kuvendi Komunal i Komunës së Glllogocit cakton normat tatimore për vitin 2024 për të gjitha kategoritë e pronave.

Për sqarime të më tutjeshme e gjeni të bashkangjitur Ligjin Nr.08/L-224 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

LIGJI NR. 08/L-224

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN
E PALUAJTSHME**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË
PRONËN E PALUAJTSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë progresivitet të shkallës tatimore, lirim tatimor për vendbanimin parësor dhe tokat bujqësore, faljen tatimore për vitin tatimor 2023 dhe rregullat kufizuese për aplikimin e detyrimit tatimor, dhe interesit, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e mëtejshëm: Ligji Bazik).

Neni 2

Riformulohet neni 9 i Ligjit Bazik dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

**Neni 9
Shkalla tatimore progresive**

1. Tatimi në pronën e paluajtshme bazohet në vlerën e vlerësuar të paluajtshmërisë së tatimpaguesit si bazë tatimore në komunën përkatëse.

2. Baza tatimore për tatimpaguesin me prona të paluajtshme brenda një komune përcaktohet si bazë e vetme tatimore sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit.

3. Vlera e detyrimit tatimor llogaritet sipas kufijve në vijim:

3.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.10% deri 1%;

3.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.20% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafi 3.1 të këtij neni;

3.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.30% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni;

3.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.40% deri 1%, plus tatimi nga nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni; dhe

3.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore që mund të variojë prej 0.50% deri 1%, plus tatimi nga nën-paragrafët 3.1, 3.2, 3.3 dhe

3.4 të këtij neni.

4. Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallët tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv.

5. Nëse Kuvendi i Komunës nuk e përcakton me kohë shkallën e tatimit sipas paragrafit 4 të këtij neni, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën e fundit tatimore të përcaktuar nga Kuvendi i Komunës.

6. Në rast se shkalla tatimore nuk është vendosur më parë, ministria përgjegjëse për financa do të zbatojë shkallën më të ulët tatimore të aplikueshme në përputhje me kufijtë e tatimit progresiv të pronës së paluajtshme përcaktuara në këtë nen.”

Neni 3

1. Pas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të nenit 10 të Ligjit Bazik, shtohen dy nën-paragrafë me tekstin si në vijim:

1.8. Për vendbanimin parësor, deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit; dhe

1.9. Për tokën bujqësore, deri në pesëdhjetë mijë (50,000) euro e para të pronës së vlerësuar si njësi bujqësore të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor për cilën njësi bujqësore e kërkon lirimin dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.

2. Fshihen paragrafët 4 dhe 5 të nenit 10 të Ligjit Bazik, dhe vendoset një paragraf i ri me tekstin si në vijim:

4. Lirimet tatimore të përcaktuara me nën-paragrafët 1.8 dhe 1.9, të paragrafit 1 të nenit 10 zbatohen vetëm një herë brenda vitit tatimor për çdo tatimpagues, pavarësisht nga numri i pronësive dhe/ose posedimeve të tatimpaguesit dhe pavarësisht faktit që njësitë mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Neni 4

Fshihet neni 11 i Ligjit Bazik.

Neni 5

Pas Kapitulli II të Ligjit bazik, shtohet Kapitulli II/A me tekstin si në vijim:

KAPITULLI II/A

FALJA E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023

Neni 11/A

Pranueshmëria

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli.

Neni 11/B**Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme**

1. Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.
2. Vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sipas kufizimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

Neni 11/C**Kufizimi**

Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

Neni 11/Ç**Administrimi**

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.
2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

Neni 6

Pas paragrafi 1 të nenit 23 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 1.a. me tekstin si në vijim:

- 1.a. Për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Neni 7

Pas paragrafit 2 të nenit 25 të Ligjit Bazik, shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

3. Në asnjë rrethanë llogaritja e interesit në tatimin e papaguar nuk do të vazhdojë të llogaritet pasi interesi i akumuluar të ketë arritur shumën e vetë tatimit të papaguar.

Neni 8

Pas nenit 30 të Ligjit bazik, shtohet neni 30/A me tekstin si në vijim:

Neni 30/A**Afati i parashkrimit të detyrimit tatimor**

1. Afati i parashkrimit të përmbarimit të detyrimit tatimor është dhjetë (10) vjeçar, duke filluar nga data e marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara sipas nenit 30 të Ligjit Bazik.
2. Pas skadimit të periudhës dhjetë (10) vjeçare, detyrimi tatimor konsiderohet i parashkruar dhe komuna nuk ka të drejtë të marrë asnjë masë përmbarimore ndaj tatimpaguesit.

3. Parashkrimi nuk zbatohet në rastet kur:

3.1. Tatimpaguesi ka paguar vullnetarisht një pjesë të detyrimit tatimor pas skadimit të periudhës dhjetëvjeçare;

3.2. Tatimpaguesi ka rënë dakord me komunën për një plan pagese ose shlyerje të detyrimit tatimor; dhe

3.3. Për detyrimin tatimor është marrë një vendim gjyqësor.

4. Afati i parashkrimit pezullohet gjatë procedurës ankimore ose gjatë një procesi gjyqësor në lidhje me detyrimin tatimor.

5. Afati i parashkrimit rifillon nga data e vendimit përfundimtar të marrë në ankim ose procedurë gjyqësore.

Neni 9

Në kapitullin X të Ligjit Bazik, Dispozita kalimtare dhe përfundimtare, pas nenit 39, shtohet një nen i ri, 39 /A, me tekstin si vijon:

Neni 39 /A

Shkalla tatimore tranzitore

Për vitin tatimor 2024 për të gjitha kategoritë e pronave të përcaktuara në nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Bazik, Kuvendet Komunale deri më 30 nëntor 2023 mund të përcaktojnë shkallën tatimore të aplikueshme e cila mund të variojë prej 0.1% deri 1%. Në rast se Kuvendet Komunale nuk marrin vendim për përcaktimin e normave tatimore, vlejnë dispozitat e ligjit bazik.

Neni 10

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Neni 2 i këtij ligji fillon të zbatohet për vitin tatimor 2025, dhe obligohet Kuvendi i Komunës që deri më 30 nëntor të vitit 2024 t'i caktojë shkallët tatimore konform nenit 2 të këtij ligji.

Ligji Nr. 08/L-224

27 korrik 2023

Shpallur me dekreten Nr. DL-148/2023, datë 14.08.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		21. 08 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01	41375	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-40, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-10338 dhe plotsim ndryshimit të rregullorës: Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12-400-37743 të datës 03.07.2018 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr 12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e OJQ "Klubi i Hendbollit Drenica" Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për mbulimin e shpenzimeve për Projektin "Aktivitete Sportive" gjatë vitit 2023.

Neni 2.

Projekti i OJQ "Klubi i Hendbollit Drenica" përkrahet me shumën prej **8,000.00 €** (tetë mijë euro) mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DKRS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencione dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/850001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në Konton e OJQ "Klubi i Hendbollit Drenica" Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. Të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ "Klubi i Hendbollit Drenica" që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa Dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Bazuar në thirrjen publike nr. 01-400/01-25649 të dt.31.05.2023 nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për ndarjen e subvencioneve për Klubet Sportive, Sportistët, Garat Sportive, Shoqëritë Amatore, Teatrot Amatore , Festivalet, Botimi i librave/ Shkrimeve letrare, Ekspozitat me fotografi/ picture, Aktivitetet me karakter garues, Pjesëmarrje në festival jashtë komune, Promovimi i talentave të rinjë për vitin 2023, OJQ "KH DRENICA" Klub i Hendbollit, ka aplikuar më dt. 29/06/2023 me projektin "Aktivitete Sportive".

Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të OJQ-ve, Kryetari I Komunës propozon Kuvendit përkrahjen me mjete financiare për OJQ-në ose personin fizik në realizimin e projektit KH Drenica "Aktivitete Sportive", në shumën prej 8,000 €.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
VJAR	21.08 2023		
Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01	51381	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-40, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-10338 dhe plotsim ndryshimit të rregullorës: Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12-400-37743 të datës 03.07.2018 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr 12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M P Ë R F I N A N C I M I N E P R O J E K T I T

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e OJQ "FC Liqeni" Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për mbulimin e shpenzimeve për Projektin "Aktivitete Sportive" gjatë vitit 2023.

Neni 2.

Projekti i OJQ "FC Liqeni" përkrahet me shumën prej **15,000.00 €** (pesëdhjetë mijë euro) mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DKRS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencione dhe transfereve, kodi ekonomik 22/611/850001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në Konton e **OJQ "FC Liqeni"**. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. Të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ "FC Liqeni" që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa Dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Bazuar në thirrjen publike nr. 01-400/01-25649 të dt.31.05.2023 nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për ndarjen e subvencioneve për Klubet Sportive, Sportistët, Garat Sportive, Shoqëritë Amatore, Teatrot Amatore , Festivalet, Botimi i librave/ Shkrimeve letrare, Ekspozitat me fotografi/ picture, Aktivitetet me karakter garues, Pjesëmarrje në festival jashtë komune, Promovimi i talentave të rinjë për vitin 2023, OJQ "FC LIQENI" Klub i Futsallit, ka aplikuar më dt. 30/06/2023 me projektin "Aktivitete Sportive".

Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve të OJQ-ve, Kryetari I Komunës propozon Kuvendit përkrahjen me mjete financiare për OJQ-në ose personin fizik në realizimin e projektit "FC LIQENI "Aktivitete Sportive", në shumën prej 15,000 €.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		21/08/2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01-	41364	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-40, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-10338 dhe plotsim ndryshimit të rregullorës: Nr.02-400/01-18380 të dt. 27.04.2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, vendimit me nr.12-400-37743 të datës 03.07.2018 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr 12-320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës para Kuvendit paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e OJQ "Klubi i Boksit Drenasi" Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për mbulimin e shpenzimeve për Projektin "Masivizimi I sportit të boksit" gjatë vitit 2023.

Neni 2.

Projekti i OJQ "Klubi i Boksit Drenasi" përkrahet me shumën prej **3,000.00 €** (tre mijë euro) mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2023.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DKRS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencione dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/850001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në Konton e OJQ "Klubi i Boksit Drenasi" Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. Të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ "Klubi i Boksit Drenasi" që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa Dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

Arsyetim

